

Vertaling Nederlands-Albanees.

Dit is de vertaling Albanees van “Keuzewijzer voor Okan leerlingen” en bevat identiek dezelfde informatie als de Nederlandse tekst. Deze vertaling mag enkel verspreid worden met de originele brontekst “Keuzewijzer voor Okan leerlingen”.



KEUZEWIJZER VOOR OKAN LEERLINGEN VAN 18

IN-Gent vzw in samenwerking met De Stap - Leerwinkel Oost-Vlaanderen

TREGUES PËRZGJEDHËS PËR NXËNËSIT 18-VJEÇARË TË OKAN

IN-Gent vzw (ojf) në bashkëpunim me De Stap - Leerwinkel Oost-Vlaanderen

Vertaling Nederlands-Albanees.

Dit is de vertaling Albanees van "Keuzewijzer voor Okan leerlingen" en bevat identiek dezelfde informatie als de Nederlandse tekst. Deze vertaling mag enkel verspreid worden met de originele brontekst "Keuzewijzer voor Okan leerlingen".

A jeni 18 vjeç?

Atëherë e keni kaluar moshën e arsimit të detyruar. Pra nuk jeni më i detyruar të shkoni në shkollë. Por, ju keni të drejtën të ndiqni arsimin e mesëm deri në fund të vitit shkollor kur mbushni vetë 25 vjeç.

Mund edhe të nisni **një trajekt shkollor në arsimin për të rriturit**. Me anë të këtyre kurseve dhe shkollimeve për të rriturit ju mësoni një profesion, merrni një diplomë ose ndiqni një kurs për hobby.

Ka shumë mundësira.

Shumicën e kurseve ose shkollimeve ju mund t'i kombinoni.

Në këtë broshurë do të gjeni informacion rreth përmbajtjes së një kursi apo shkollimi, çfarë kosto kanë dhe sa zgjasin, si dhe çfarë mund të bëni pas studimeve, çfarë diplome do të merrni. Pra do të gjeni informacion të përgjithshëm.

Keni nevojë për më shumë informacion? Shikoni pyetjen "Kush mund të më ndihmojë" tek faqja 4.

Kjo broshurë gjendet në websitin **www...** Është përkthyer në disa gjuhë që t'ju ndihmojë. Me anë të këtij versioni online ju mund të shkoni në faqen e duhur të internetit për më shumë informacion me vetëm një 'klikim'.

Shumë suksese!

***më shumë informacion rreth arsimit të detyruar gjeni këtu:**

<https://www.vlaanderen.be/leerplicht-en-schoolplicht>


PËRMBAJTJA E LËNDËS

1. Cilat pyetje janë të rëndësishme?	4
2. Çfarë është trajekti i integrimit?	5
3. Çfarë është Parkoer?	6
4. Çfarë është një shkollë profesionale dhe trajnimi profesional?	7
5. Çfarë kursesh ka për Holandishten?	8
6. Çfarë mund të ndjek unë rreth zhvillimit personal?	9
7. Informacion i dobishëm	10

Disa mundësi studimi

8. Një diplomë e arsimit të mesëm nëpërmjet Arsimit të Mesëm për të Rriturit (Secundair Volwassenenonderwijs - CVO)	11
9. Një diplomë e arsimit të mesëm nëpërmjet Komisionit të Ekzaminimit për Arsimin e mesëm (Examencommissie Secundair onderwijs)	12
10. Arsimi i lartë: Graduatët	13
11. Arsimi i lartë: HBO5 infermieri	14
12. Arsimi i lartë: Bachelor	15

1. Cilat pyetje janë të rëndësishme?

Çfarë duhet të zgjedh ?	Ekzistojnë mundësi dixhitale falas që mund t'ju ndihmojnë të zgjidhni studimet apo profesionin (shikoni informacioni në faqen 10). A e keni bërë zgjedhjen rreth studimeve apo profesionit? Atëherë mund të zgjidhni shkollën ose qendrën e shkollimit. Në këtë broshurë do të merrni më shumë informacion rreth mundësive brenda trajektit të edukimit për të rriturit . Shumicën e kurseve apo shkollimeve mund ti kombinoni.
Cila është përmbajtja e shkollimit/kursit?	Ju do të merrni informacion rreth përmbajtjes së lëndës mësimore dhe se si organizohen mësimet. Ka degë studimi me më shumë praktikë ose të tjera me më shumë teori . Nganjëherë mësimet organizohen në darkë... Këshillë: për më shumë informacion vizitoni faqen e internetit të shkollës, shikoni në ditët e "dyerve të hapura" kur shkolla mirëpret të interesuarit për t'u dhënë informacion, dhe nëse është e nevojshme lini një takim. Gjatë një bisede me shkollën ose qendrën e shkollimit (opleidingscentrum) ju mund të kërkonti të gjitha informacionet e nevojshme.
Sa do të zgjasë ?	Kjo varet nga trajekti juaj personal: sa modula mësimore do të ndiqni, do studioni me kohë të plotë apo në shkollë nate... Në arsimin e lartë flitet për pikët e studimit: një trajekt normal përmban 60 pikë studimi në 1 vit. Ju mund ta krahasoni kohëzgjatjen e studimeve në shkolla të ndryshme.
Ku fokusohet një shkollim? Çfarë mund të bëj unë më pas?	Një shkollim mund të jetë një përgatitje për studime të mëtejshme apo për një profesion .
Është falas apo duhet të paguaj? Sa është kosto-ja?	Shpesh ju duhet të paguani për regjistrimin, instrumentet e punës, rrobat e punës, librat. Ka edhe kurse dhe programe falas siç është Parkoer tek IN-Gent vzw (ojf) (shikoni faqen 6), ka kurse tek VDAB (faqja 7) dhe CBE (faqet 8-9). Këshillë: - Interesohuni nëse keni të drejtë për ndonjë ulje. - Bëni pyetje rreth groeipakket (paketa e rritjes). Kjo paketë përfshin midis të tjerash një ndihmë financiare për të rinjtë nën 25 vjeç. Pyesni nëse ju mund të përfitoni nga kjo paketë apo e humbisni këtë të drejtë. www.groeipakket.be
Cilat janë kushtet e pranimit?	Këto janë: mosha, dokumentet e qëndrimit, niveli i gjuhës, kërkesat rreth diplomës.
Çfarë diplome do të marr?	Ju do të merrni një vërtetim, ose një certifikatë, ose një dëshmi ose një diplomë.
A merren parasysh eksperiencat dhe studimet e mia në vendin tim ?	Eksperiencat dhe studimet e tua të mëparshme luajnë një rol të rëndësishëm. Sa kohë keni studiuar? Çfarë keni mësuar? Keni bërë praktikë apo eksperiencë pune? A keni një diplomë apo një certifikatë të arsimit të mesëm nga vendi juaj? Mbajini mirë këto certifikata apo diploma nga vendi juaj apo nga Belgjika, mund t'ju hyjnë në punë. Këshillë: -Nganjëherë ju mund ta njësoni diplomën që keni marrë në vendin tuaj. Në këtë rast ju jepet një dokument që e krahason diplomën tuaj me një diplomë Flamande. Në këtë mënyrë një punëmarrës kupton se çfarë lloj diplome keni. Për njësimin duhet të bëni një kërkesë tek Naric Vlaanderen https://www.naricvlaanderen.be/erkenning-aanvragen-bij-naric-of-andere-instantie#onderwijsinstelling . Banoni në Gent? In-Gent vzw (ojf) mund t'ju ndihmojë me njësimin.
Ku mund të studjoj? Si mund të marr një diplomë ?	Ka shkollime që janë të fokusuar tek studimi i mëtejshëm. Tek faqet 11-15 dhe 5-10 do gjeni informacion interesant. Edhe arsimit të mesëm ju përgatit për arsimin e lartë. Për këtë mund të ndiqni degën përgatitore (doorstroomrichting). Holandishten mund ta përmirësoni duke ndjekur një kurs NT2 (faqja 8).
Si mund të gjej një punë fikse?	Të dini mirë Holandishten (faqja 8) dhe një kurs profesional (faqja 7), i rrisin shanset tuaja për të gjetur një punë fikse. Trajekti i integrit (faqja 5) ose Parkoer (faqja 6) mund të jenë interesante për ju. Tek faqet 9-10 ju do të gjeni informacion interesant. Doni të merrni një diplomë? Lexoni faqen 11-15.
Kush mund të më ndihmojë ?	Personi udhëzues i Okan mund t'ju ndihmojë të bëni një zgjedhje. Me pyetje rreth shkollimeve apo kurseve ju mund të drejtoheni tek De Stap-Leerwinkel Oost-Vlaanderen , info@destagent.be , 09 233 75 15, tek biblioteka De Krook, kati i dytë, Miriam Makebaplein 1, 9000 GENT. Këtu do t'ju ndihmojnë.  Me pyetje rreth integrit, kurseve të Holandishtes, Parkoer, shkollimit për të rritur, dhe njësimin të diplomës mund të drejtoheni tek IN-Gent vzw (ojf) , info@in-gent.be , 09 265 78 40,

Vertaling Nederlands-Albanees.

Dit is de vertaling Albanees van "Keuzewijzer voor Okan leerlingen" en bevat identiek dezelfde informatie als de Nederlandse tekst. Deze vertaling mag enkel verspreid worden met de originele brontekst "Keuzewijzer voor Okan leerlingen".

Kongostraat 42, 9000 Gent. Këtu do t'ju ndihmojnë.



Banoni në Gent? Shikojeni njëherë faqen e internetit për integrimin:

<https://www.integratie-inburgering.be/nl/landingspagina-inburgering>

Vertaling Nederlands-Albanees.

Dit is de vertaling Albanees van "Keuzewijzer voor Okan leerlingen" en bevat identiek dezelfde informatie als de Nederlandse tekst. Deze vertaling mag enkel verspreid worden met de originele brontekst "Keuzewijzer voor Okan leerlingen".


2. Çfarë është trajekti i integrimit?

Përmbajtja	<p>-Këtë trajekt integrimi ju mund ta ndiqni tek një agjenci integrimi (In-Gent në Gent, Atlas në Antwerpen, dhe Agjencia Flamande në të gjitha qytetet dhe bashkitë Flamande).</p> <p>- Si fillim ju duhet të nënshkruani një kontratë integrimi. Në këtë kontratë ne mundohemi që së bashku të përpilojmë një trajekt që ju përshtatet.</p> <p>- Programi i integrimit përbëhet nga disa pjesë, dhe që nga 1 janari i vitit të ardhshëm do përmbajë 4 të tilla.</p> <ul style="list-style-type: none">- Kursin e Holandishtes (NT2 - nivelet A1 dhe A2),- Kursin "orientimi në shoqëri" në gjuhën tuaj amtare ose në një gjuhë tjetër që ju dini.- Udhëzuesi personal (një person) do t'ju ndihmojë gjatë programit të integrimit me pyetjet që mund të keni dhe do t'ju drejtojë tek VDAB. Ju keni dhe mundësinë të zgjidhni të studioni më tej apo të rivazhdoni studimet.- Ju do të zgjidhni një aktivitet ku do të njiheni me njerëz të tjerë (rrjet social) ose do të angazhoheni në mënyrë aktive për komunitetin (pjesëmarrje): do të zgjidhni një hobby (sport, kohë e lirë), punë vullnetare, një praktikë për t'u njohur me një profesion të caktuar, ju mund të flisni me buddy-n tuaj (rreth kohës së lirë, rreth punës...) <p>-Të gjitha këto pjesë përbërëse të trajektit të integrimit ju mund ti ndiqni njëkohësisht. Mund edhe të lirohëni nga detyrimi i ndjekjes së ndonjë pjese të trajektit psh. në rast se bëni provimin e orientimit në shoqëri apo jepni provimin e gjuhës (NT2) ose sepse jeni duke studjuar apo duke punuar për momentin (rrjet social dhe pjesëmarrja).</p> <p>-Mësimet janë gjatë ditës, në mbrëmje ose të shtunave.</p>
Kohëzgjatja	<p>-varet nga trajekti juaj personal. Kur nënshkruani kontratën parashikohet dhe një kohëzgjatje e caktuar. Ky afat varet nga zgjatja e trajektit të mësimin të Holandishtes.</p>
Fokusuar rreth	<p>- Ju do të mësoni rreth shoqërisë në Flandër, dhe shërbimeve në qytetin tonë dhe gjithë Flandrën. Në këtë mënyrë do ndiheni shpejt si në shtëpinë tuaj.</p> <p>-Ju do të përgatiteni të merrni pjesë në mënyrë aktive në shoqëri.</p> <p>-Pas programit ju mund të vazhdoni të mësoni më tej Holandishten, apo të ndiqni një kurs profesional, apo të studjoni (shikoni për më shumë informacion në vazhdim të kësaj broshure).</p>
Kosto-ja	<p>-Deri në datën 31 dhjetor 2021 trajekti i integrimit është falas.</p> <p>-Nga 2022 duhet të paguani për trajektin (360 euro për trajektin e plotë. Të gjithë informacionin e duhur rreth kësaj mund ta gjeni në faqen e internetit).</p>
Kushtet e pranimit	<p>- të jeni 18 vjeç</p> <p>- të jeni regjistruar në regjistrin e të huajve apo në regjistrin e popullsisë (nga 2022)</p> <p>- të plotësoni kriteret për ndjekjen e trajektit të integrimit</p> <p>- Mbase jeni i detyruar ta ndiqni programin e integrimit. Në këtë rast do të merrni një letër. Reagoni gjithnjë nëse merrni letrën rreth integrimit. Ne do të shikojmë bashkë me ju mundësitë.</p>
Diploma	<p>Ju do të merrni një atest integrimi. Për këtë ju duhet t'i kaloni suksesshëm të gjitha pjesët e integrimit që janë caktuar në kontratën tënde. Një atest integrimi është një vërtetim i integrimit shoqëror (i nevojshëm për të marrë nënshkrimin).</p>
Informacion shtesë	<p>Ka një program të veçantë për të rinjtë: Parkoer (shikoni më shumë informacion në faqen 6).</p> <p>Më shumë informacion rreth integrimit: Filma: https://www.youtube.com/watch?v=8B-7MdFodbQ</p> <p>Integrimi: https://www.integratie-inburgering.be/nl/landingspagina-inburgering</p> <p>Integrimi Gent (me video në gjuhë të ndryshme): https://www.in-gent.be/voor-jou/inburgeren</p> <p>IN-Gent vzw (ojf) i ndihmon banorët e Gent-it edhe me:</p> <ul style="list-style-type: none">- regjistrimin për një kurs Holandishteje (NT2), (edhe nëse ju nuk jetoni në Gent mund të ndiqni një kurs në Gent),- bursa për UTC në bazë të disa kriterëve të caktuara,- praktikimin e gjuhës Holandeze,- testet civile (për të marrë një vërtetim të njohjes së gjuhës Holandeze),-njësimin e diplomës,- gjetjen e një shkolle për fëmijët të cilët sapo kanë ardhur në Belgjikë,- gjetjen e çerdhes/kopshtit kur ju duhet të filloni të ndiqni vetë një kurs,- ndihmë për të vazhduar arsimin e lartë,- takime dhe aktivitete në kohën e lirë...
Ndihmë	<p>-A jetoni në Gent? Kontaktoni IN-Gent vzw (ojf), https://www.in-gent.be/, info@in-gent.be, 09 265 78 40, Kongostraat 42, 9000 Gent.</p> <p>-A jetoni diku tjetër në Flandër? Vizitoni websitin e integrimit: https://www.integratie-inburgering.be/nl/landingspagina-inburgering</p>

Vertaling Nederlands-Albanees.

Dit is de vertaling Albanees van "Keuzewijzer voor Okan leerlingen" en bevat identiek dezelfde informatie als de Nederlandse tekst. Deze vertaling mag enkel verspreid worden met de originele brontekst "Keuzewijzer voor Okan leerlingen".

3. Çfarë është Parkoer

	<p>-Ju ndiqni një kurs orientimi në shoqëri për të rinjtë. Ju do të mësoni shumë rreth Belgjikës dhe Flandrës. Do bëni ekskursionë dhe do të njiheni me shokë/shoqe.</p> <p>-Personi udhëzues i trajektit do t'ju ndihmojë me pyetjet që keni. Kjo ndihmë personale nuk ndalet edhe mbas kursit, ju mund të vazhdoni të mbani kontaktet me udhëzuesin tuaj të trajektit.</p> <p>- Me anë të "Parkoer " ju mund të kaloni tek trajekti i integritimit (shikoni informacionin rreth trajektit të integritimit në faqen 5).</p>
Kohëzgjatja	-2 javë gjatë pushimeve (pushimeve të Pashkëve ose pushimeve verore)
Fokuset në	-Bashkë me të rinjtë të tjerë ju do të mësoni rreth shoqërisë dhe shërbimeve të ndryshme. Kjo do t'ju ndihmojë në jetën e përditshme në Belgjikë.
Kosto-ja	-Falas
Kushtet e pranimit	-Jeni nga 17 deri 19 vjeç dhe vini nga një shtet jashtë Bashkimit Evropian. - A keni kërkuar azil në Belgjikë dhe po prisni një përgjigje? Atëherë do të regjistrohemi në një regjistër pritjeje. Qëndrimi juaj në Belgjikë nuk është akoma i sigurt. Ju nuk mund të ndiqni trajektin e integritimit por mund të ndiqni Parkoer.
Diploma	Ju do të merrni : -një vërtetim të orientimit në shoqëri . Me këtë keni kryer një pjesë të programit të integritimit. Nëse merrni dhe nivelin A2 të Holandishtes, ju jepet atesti i integritimit. Atesti i integritimit është i mundur nga mosha 18 vjeç .
Informacion shtesë	Parkoer https://www.in-gent.be/parkoer Film: https://www.youtube.com/watch?v=xSd1qGfsCR8
Ndihmë	Parkoer parkoer@in-gent.be 0483 41 30 62 IN-Gent vzw (ojf), Kongostraat 42, 9000 Gent

Vertaling Nederlands-Albanees.

Dit is de vertaling Albanees van “Keuzewijzer voor Okan leerlingen” en bevat identiek dezelfde informatie als de Nederlandse tekst. Deze vertaling mag enkel verspreid worden met de originele brontekst “Keuzewijzer voor Okan leerlingen”.

Vertaling Nederlands-Albanees.

Dit is de vertaling Albanees van “Keuzewijzer voor Okan leerlingen” en bevat identiek dezelfde informatie als de Nederlandse tekst. Deze vertaling mag enkel verspreid worden met de originele brontekst “Keuzewijzer voor Okan leerlingen”.

4. Çfarë është një shkollim profesional dhe trajnimi?

Përmbajtja	<p>-Ju do të mësoni një profesion ose do të ndiqni një specializim në mënyrë që të gjeni sa më shpejt një punë.</p> <p>-Ju ndiqni një shkollim tek:</p> <ul style="list-style-type: none"> -Centrum voor Basiseducatie (CBE) – qendra për arsimin bazë, -CVO (qendra për arsimin për të rritur), -VDAB për ata që nuk janë në punë (Qendra Flamande për Punësimin dhe Shkollimin profesional) -Syntra,... <p>-Ju do ta ndiqni mësimin gjatë ditës dhe/ose gjatë mbrëmjes dhe/ose në distancë.</p> <p>(Jeni të interesuar në profesionet me uniformë, si zjarrfikës, polic, ushtar, aviator? Atëherë mund të gjeni më shumë informacion në broshurën ‘De wijze stap’ (Hapi i mençur) në faqen e internetit: https://www.destapgent.be/materialen/brochure_de-wijze-stap.php).</p>
Kohëzgjatja	Një shkollim mund të zgjasë nga disa muaj deri në disa vite.
Fokusohet në	<p>-Pas një shkollimi keni më shumë mundësi të gjeni një punë fikse.</p> <p>Se sa shpejt mund të gjeni një punë, varet nga sektori dhe profesioni (nëse ka shumë kërkesa). Për sqarim: profesionet shumë të kërkuara janë profesione për të cilat nuk ka mjaftueshëm fuqi punëtore.</p>
Kosto-ja	<p>- Të gjitha kurset e VDAB janë falas për ata që janë në kërkim të një pune.</p> <p>Ju mund të ndiqni dhe një shkollim të lartë psh. për infermieri (shikoni faqen 14), nëpërmjet VDAB-së. Nëse ndiqni një shkollim i cili njihet nga VDAB, atëherë është VDAB që jua paguan shkollimin.</p> <p>-Tek CVO mund të merrni një ulje të çmimit, psh. nëse të ardhurat tuaja janë të ulëta.</p> <p>-Tek Syntra jo çdo shkollim ka të njëjtin çmim. Ju nuk mund të kërkonte ulje.</p>
Kushtet e pranimit	<p>-dokumentet e qëndrimit.</p> <p>-Tek VDAB duhet të jeni 18 vjeç dhe të keni njohuri bazë të Holandishtes për të ndjekur një shkollim. Duhet të regjistroheni si punë-kërkues.</p> <p>-Tek CVO mund të filloni me një shkollim profesional që nga moshja 16 vjeç ose që nga moshja 15 vjeç nëse keni ndjekur 2 vite të shkollës së mesme.</p> <p>Këtë shkollim tek CVO duhet ta ndiqni në darkë... sepse jeni akoma në moshën që duhet të ndiqni arsimin e detyruar, pra duhet të shkoni në shkollën e mesme gjatë ditës. Nga moshja 18 vjeç nuk jeni më i detyruar të shkoni në shkollë prandaj mund të ndiqni një shkollim profesional edhe gjatë ditës. Duhet të keni njohuri të mira të Holandishtes (në të folur dhe kuptuar).</p> <p>-Tek Syntra mund të fillosh nga moshja 18 vjeçare. Për disa shkollime duhet të kesh diplomën e arsimit të mesëm ose të kalosh me sukses një provim pranues ose procedurën e EVC/EVK.</p>
Diploma	<p>Ju do të merrni</p> <ul style="list-style-type: none"> - një atest, një certifikatë (të pjesshme) ose një diplomë.
Informacion shtesë	<p>Përpos kursit profesional tek VDAB-ja do të mësoni edhe:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Holandishten (parapregatitje për një profesion), - si ta zgjedh një profesion, - si të gjej punë, <p>Me anë të një trajekti OKOT të VDAB-së ju mund të merrni një diplomë të arsimit të mesëm ose të arsimit të lartë (“graduaat” ose bachelor profesional), ose një certifikatë të se-n-se (shkollë e mesme pas një shkolle të mesme). Për më shumë informacion shikoni www.vdab.be/opleidingen</p> <p>Shkruani “OKOT” në shiritin e kërkimit.</p> <p>VDAB: https://www.vdab.be/anderstalig https://www.vdab.be/opleidingen</p> <p>VDAB në English: https://www.vdab.be/english</p> <p>CVO: https://www.onderwijs.vlaanderen.be/nl/een-beroep-een-taal-of-ict-vaardigheden-aanleren</p> <p>Syntra Midden-Vlaanderen: https://www.syntra-mvl.be/</p> <p>E përgjithshme: Broshura “De wijze stap”: https://www.destapgent.be/materialen/brochure_de-wijze-stap.php</p>
Ndihmë	<p>-Nëse ndiqni programin e integritit ose Parkoer, atëherë IN-Gent vzw (ojf) do t’ju ndihmojë (shikoni informacionin në faqen 5 dhe 6).</p> <p>-De Stap- Leerwinkel Oost-Vlaanderen www.destapgent.be</p>

Vertaling Nederlands-Albanees.

Dit is de vertaling Albanees van “Keuzewijzer voor Okan leerlingen” en bevat identiek dezelfde informatie als de Nederlandse tekst. Deze vertaling mag enkel verspreid worden met de originele brontekst “Keuzewijzer voor Okan leerlingen”.

-CVO, VDAB, Syntra

Vertaling Nederlands-Albanees.

Dit is de vertaling Albanees van "Keuzewijzer voor Okan leerlingen" en bevat identiek dezelfde informatie als de Nederlandse tekst. Deze vertaling mag enkel verspreid worden met de originele brontekst "Keuzewijzer voor Okan leerlingen".

5. Çfarë kursesh ka për Holandishten?

Përmbajtja	<p>-Holandishtja nuk është gjuha juaj amtare, por gjuha juaj e dytë. Prandaj ne flasim gjithnjë për një kurs NT2 (Holandishtja për të huajt).</p> <p>-Ju e mësoni Holandishten hap pas hapi. Ka disa nivele, si psh. mësimi i alfabetit (gërma Latine), A1 (modula 1.1), A2 (modula 1.2), B1 (përmban 4 modula), B2 (modula 3.2), C1 (modula 4.2), C2.</p> <p>-Ka disa shkolla/instanca shkollimi që organizojnë kurse për Holandishten, si CVO, CBE, UCT (qendra universitare për gjuhët), VDAB.</p> <p>-mësimet janë gjatë ditës, ose në darkë, nganjëherë në fundjavë, 3 – 4 orë në ditë.</p> <p>-IN-Gent vzw (ojf) ju ndihmon të gjeni kursin e duhur. Ju do të bëni një test llogjike dhe mbase dhe një test pranimit për gjuhën Holandeze. Ne ju regjistrojmë për kursin ose ju referojmë në shkollën e duhur.</p>
Kohëzgjatja	<p>-Kohëzgjatja e kursit mund të ndryshojë. Një kurs me 4 deri 5 mësimet në javë ecën më shpejt se një kurs me vetëm një mësim në javë.</p> <p>-Një kurs A1 zgjat 1 muaj tek UCT, 3 muaj te CVO dhe 1 vit te CBE. Nëse mësoni fillimisht alfabetin, zgjat 2.5 vite për të marrë nivelin e parë (A1).</p>
Fokusohet në	<p>-E mësoni Holandishten për në jetën e përditshme.</p> <p>-Për informacion: nëse ndiqni një kurs Holandishteje tek VDAB, mësoni Holandishten që ju duhet për të bërë një punë. Për të filluar ju duhet të keni njohuri bazë të Holandishtes (shikoni informacionin për VDAB tek faqja 7).</p>
Kosto-ja	<p>-Çmimi ndryshon nga shkolla në shkollë dhe varet dhe nga kursi.</p> <p>-Me një bursë ju mund të regjistroheni me çmim më të ulët tek UCT-ja (Qendra Unversitare për gjuhët).</p> <p>Informohuni atje nëse mund të regjistroheni me çmim të reduktuar.</p>
Kushtet e pranimit	<p>-Një kurs NT2 ju mund ta ndiqni që nga moshja 16 vjeçare. Ju mund të ndiqni mësimet të NT2 në kombinim me shkollën tuaj.</p> <p>-dokumentet e qëndrimit Nuk keni qëndrim legal? Shikoni mundësinë për të mësuar Holandishten me anë të Wegwijs in Gent: http://wegwijsingent.be/taal</p>
Diploma	<p>Ju do të merrni një çertifikatë (të pjesshme) për çdo modulë.</p>
Informacion shtesë	<p>Përmbledhje e niveleve: https://www.in-gent.be/sites/default/files/overzicht%20niveaus%20NT2%20-%20Nieuwe%20ERK-berg.pdf</p> <p>Informacion i IN-Gent vzw (ojf): https://www.in-gent.be/voor-jou/nederlands/wil-je-nederlands-leren</p> <p>Ju mund të ushtroni/mësoni Holandisht-en në kohën e lirë https://www.in-gent.be/voor-jou/nederlands/oefenen :</p> <ul style="list-style-type: none"> - Pennenvrienden (shkëmbin e-mailesh me një person që e flet shumë mirë Holandishten), - Bashkëbisedim online (ushtroni Holandishten në një grup online me një person që drejton <i>bisedën</i>). - Praktikimi i Holandishtes në shtëpi (këshilla rreth aplikacioneve apo faqeve të internetit ku mund të ushtroni Holandishten), - Open-bar, koffieklets (<i>bisedime në grup</i> ku mund të ushtroni Holandishten). Më shumë informacion gjeni në faqen e internetit https://in-gent.be/voor-jou/ontmoeting-en-vrije-tijd, - Samen Gentenaar (dilni shëtitje me një banor të Gent-it, njihuni me Gent-in dhe ushtroni Holandishten). Më shumë informacion gjeni këtu: https://in-gent.be/samen-gentenaar .
Ndihmë	<p>IN-Gent vzw, info@in-gent.be , 09 265 78 40,</p>

Vertaling Nederlands-Albanees.

Dit is de vertaling Albanees van “Keuzewijzer voor Okan leerlingen” en bevat identiek dezelfde informatie als de Nederlandse tekst. Deze vertaling mag enkel verspreid worden met de originele brontekst “Keuzewijzer voor Okan leerlingen”.

Kongostraat 42, 9000 Gent.

Vertaling Nederlands-Albanees.

Dit is de vertaling Albanees van "Keuzewijzer voor Okan leerlingen" en bevat identiek dezelfde informatie als de Nederlandse tekst. Deze vertaling mag enkel verspreid worden met de originele brontekst "Keuzewijzer voor Okan leerlingen".

6. Çfarë mund të ndjek për zhvillimin personal?

Përmbajtja	<p>-Nuk keni vajtur gjatë në shkollë dhe doni të mësoni diçka thjesht se ju duket interesante, apo për punën, apo si përgatitje të studimeve tek një CVO (Qendra e arsimit për të rritur) ose si përgatitje për provimin teorik të patentës? Atëherë ju mund të ndiqni mësim tek CBE (Qendra për arsimin bazë). https://www.ligo.be/</p> <p>Ju mund të mësoni rreth: matematikës së thjeshtë, gjuhës, shoqërisë, ICT, provimit teorik për patentën...</p> <p>-Tek një CVO (Qendër e arsimit për të rritur) https://data-onderwijs.vlaanderen.be/onderwijsaanbod/lijt?n=4&hz=true&hs=317+417&f=gent</p> <p>ti mund të: mësoh rreth ICT, të mësoh një gjuhë të huaj (psh. Frëngjisht, Anglisht, gjuhën Polake, Rusisht, Arabisht, Turqisht...) të ndiqni një kurs si qepja, përpunimi i drurit, gatimi, ...</p> <p>-Doni të merreni me diçka kreative dhe të zhvilloni anën tuaj artistike (psh. një kurs rreth pikturës, fotografisë, teatrit, violinës,...) atëherë mund të ndiqni mësim tek akademia e arteve. (Arsimi me kohë të pjesshme për artin (DKO)) https://www.academiegent.be/</p> <p>-Do të bëhesh trajner sporti, të drejtosh aktivitete sportive apo kampe, atëherë mund të ndjekësh një trajnim tek Vlaamse Trainersschool https://www.sport.vlaanderen/trainers-en-sportbegeleiders/opleiden-en-bijscholen/opleidingen/</p> <p>-Nëse do të ndjekësh një aktivitet formimi të shkurtër (psh. një kurs mindfulness, përpunim qeramike, një shëtitje në natyrë,...) atëherë mund të drejtoheni tek iniciativat e shumta të rrjetit socio-kulturor të arsimit për të rriturit.</p> <p>Ka një numër të madh kurseesh të mundshme, edhe iniciativa private.</p>
Kohëzgjatja	-varet nga kursi
Fokuset në	-zhvillimin personal
Kosto-ja	-Nganjëherë kurset janë falas (psh. tek CBE). Për shumicën e kurseve duhet të paguani një kuotë për regjistrimin. Nganjëherë ka dhe ulje çmimi.
Kushtet e pranimit	- nga 18 vjeç - Për tek akademia me kohë të pjesshme e arteve dhe tek CVO mund të ndiqni ndonjë kurs edhe nëse jeni më i ri se 18 vjeç.
Diploma	Juve do të merrni: -Një dëshmi, atest, çertifikatë (të pjesshme), një atest për pjesëmarrjen, ...
Informacion shtesë	De Stap - Leerwinkel Oost-Vlaanderen: https://www.destapgent.be/vol/persoonlijke-ontplooiing.php
Ndihmë	De Stap - Leerwinkel Oost-Vlaanderen , info@destapgent.be , 09 233 75 15, tek biblioteka De Krook, kati i 2-të, Miriam Makebaplein 1, 9000 GENT.

Vertaling Nederlands-Albanees.

Dit is de vertaling Albanees van "Keuzewijzer voor Okan leerlingen" en bevat identiek dezelfde informatie als de Nederlandse tekst. Deze vertaling mag enkel verspreid worden met de originele brontekst "Keuzewijzer voor Okan leerlingen".

--	--

Vertaling Nederlands-Albanees.

Dit is de vertaling Albanees van "Keuzewijzer voor Okan leerlingen" en bevat identiek dezelfde informatie als de Nederlandse tekst. Deze vertaling mag enkel verspreid worden met de originele brontekst "Keuzewijzer voor Okan leerlingen".

7. Informacion i dobishëm.

-Punë vullnetare për të fituar eksperiencë dhe për të **ndihmuar**

Vacatures : Vrijwilligerswerk (klikoni këtu për të parë vendet ku kërkohen vullnetarë)

<https://eportfolio.vrijwilligerspunt.stad.gent/home>

-punë gjatë pushimeve të shkollës ose **punë për studentët** për të fituar diçka më shumë

<https://stad.gent/nl/student-gent/werken-tijdens-je-studies/jobstudenten>

-Ka **mënyra dixhitale falas** që mund t'ju ndihmojnë **në zgjedhjen e studimeve apo profesionit** në faqen e internetit: <https://www.onderwijskiezer.be/v2/index.php>

Ose në faqen e VDAB-së: <https://www.vdab.be/>

Dhe

<https://www.vdab.be/welke-job-past-bij-me>

-Informacion rreth **punës për studentët, patentës, studimeve dhe temave të tjera** mund t'i gjeni tek websiti për **të rinj**: www.watwat.be

Takime, muzikë, sport dhe aktivitete dëfryese në kohën tuaj të lirë mund t'i gjeni këtu: [//participatiemarkt.in-gent.be](http://participatiemarkt.in-gent.be)

Vertaling Nederlands-Albanees.

Dit is de vertaling Albanese van "Keuzewijzer voor Okan leerlingen" en bevat identiek dezelfde informatie als de Nederlandse tekst. Deze vertaling mag enkel verspreid worden met de originele brontekst "Keuzewijzer voor Okan leerlingen".

8. Marrja e diplomës së shkollës së mesme me anë të arsimit të mesëm për të rriturit (CVO).

Përbajtja	<p>- Ju ndiqni arsimin e mesëm në një CVO (qendër për arsimin për të rriturit).</p> <p>- Mësimet janë të organizuara në modula.</p> <p>- Ju do të ndiqni mësim gjatë ditës, në mbrëmje ose në fundjavë. Nganjëherë mësimet mund t'i kombinosh me studim në mënyrë të pavarur.</p> <p>-Janë të mundura 2 trajekte të ndryshme:</p> <p>1) Shkolla e mesme e përgjithshme (ASO) - me vetëm lëndë teorike.</p> <p>2) Shkolla profesionale (me lëndë praktike për të mësuar një profesion) + një kurs (Formim i përgjithshëm shtesë - AAV) (ku do të keni lëndë të përgjithshme teorike si Holandishtja, matematika etj).</p> <p>-Ju nuk jeni i detyruar t'i ndiqni të dyja kurset njëkohësisht.</p> <p>-Ju nuk jeni as i detyruar që t'i ndiqni në të njëjtën CVO.</p> <p>-Ju mund të zgjidhni nga një listë e gjatë kurseesh apo shkollash profesionale të cilat ju japin një diplomë: https://www.onderwijskiezer.be/v2/volwassen/volw_secundair_studiegebieden2.php</p>
Kohëzgjatja	<p>-varet nga trajekti juaj profesional</p> <p>Nëse studjoni me kohë të plotë dhe duhet t'i ndiqni të gjitha lëndët, atëherë kohëzgjatja mund të jetë 2 vite. Ka edhe trajekte prej 1 ose 1.5 vitesh.</p>
Fokusohet në	<p>-përgatitjen për shkollën e lartë ose punë.</p>
Kosto-ja	<p>-nuk duhet të paguani për regjistrimin në AAV apo ASO</p> <p>-paguhen shpenzimet për materialet shkollore (si librat)</p> <p>-duhet të paguani për regjistrimin në një shkollë profesionale</p> <p>-nganjëherë mund të merrni një ulje ose nuk ka nevojë të paguani. Interesohuni për kushtet.</p> <p>-ju do të vazhdoni të keni të drejtën e marrjes së kindergeld (ndihmë financiare për fëmijët) -(www.groeipakket.be) nëse ndiqni të paktën 17 orë mësim në javë.</p> <p>-pas marrjes së diplomës së shkollës së mesme ju mund të kërkonti një shpërblim tek qeveria Flamande e cila ju rimbursos koston e regjistrimit.</p>
Kushtet e pranimit	<p>- për ASO dhe AAV duhet të jeni 18 vjeç ose të mbushni 18 vjeç para 31 dhjetorit të vitit shkollore.</p> <p>-Ju dini mjaftueshëm Holandisht për të ndjekur mësimet. Këtë duhet ta tregoni në një test gjuhësor.</p> <p>-Ju keni marrë nënshtetësinë Belge ose keni qëndrim legal në Belgjikë.</p> <p>- Ju merrni pjesë në sesionet informuese dhe bëni dhe një bisedë të parë (intake). Ju keni edhe mundësinë të bëni provime për një lëndë që e zotëroni, në mënyrë që të mos e ndiqni mësimin e asaj lënde.</p>
Diploma	<p>Ju do të merrni:</p> <p>- një certifikatë të pjesshme nëse e kaloni me sukses një modulë.</p> <p>- një diplomë të arsimit të mesëm nëse i kaloni me sukses të gjitha modulat e ASO.</p> <p>- Certifikatat që ju do të merrni në formimet e AAV dhe në shkollat profesionale, bëjnë së bashku diplomën e arsimit të mesëm.</p>
Informacion shtesë	<p>Ju mund të përgatiteni për këto studime me anë të (halkës sociale) sociale schakel plusKLAS (OKAN pas OKAN). Kërkonti më shumë informacion tek udhëzuesi juaj i OKAN.</p> <p>Për informacion rreth Oost-Vlaanderen: Shikoni pyetjen "Si mund të marr diplomën e shkollës së mesme në arsimin për të rritur" në faqen e internetit të De Stap- Leerwinkel Oost-Vlaanderen: https://www.destappent.be/faq/faq_list.php?categorieid=5</p> <p>https://www.destappent.be/files/kcfinder/files/2019-2020/1911DiplomagerichteTrajectenSchema.pdf</p> <p>Ju do ti gjeni të gjitha mundësitë e marrjes së diplomës së shkollës së mesme në faqen e internetit: https://www.onderwijskiezer.be/v2/volwassen/volw_gndiploma.php</p> <p>Për çfarë është një diplomë e arsimit të mesëm (SO) interesante?</p> <p>Një diplomë SO:</p> <p>- të bën të kualifikuar.</p> <p>- çdo diplomë e arsimit të mesëm, si ASO, BSO, KSO dhe TSO ju japin të drejtën të filloni arsimin e lartë.</p> <p>- mund t'ju ndihmojë të gjeni një punë;</p> <p>- mund të influencojë në mundësitë tuaja për t'u ngjitur në karrierë dhe rrogë më të mirë;</p> <p>- ju jep të drejtën e pranimit në nivelin C të punësimit në qeveri.</p> <p>Përveç kësaj është një mënyrë për t'u zhvilluar personalisht.</p>
Ndihmë	<p>-De Stap -Leerwinkel Oost-Vlaanderen www.destappent.be</p> <p>-Jeni midis 17 dhe 25 vjeç? Banoni apo studioni apo punoni në Gent?</p> <p>Kontaktoni Word Wijs për ndihmë në zgjedhjen, studimin dhe marrjen e një kualifikimi apo diplome të arsimit të mesëm. Është falas dhe pa</p>

Vertaling Nederlands-Albanees.

Dit is de vertaling Albanees van “Keuzewijzer voor Okan leerlingen” en bevat identiek dezelfde informatie als de Nederlandse tekst. Deze vertaling mag enkel verspreid worden met de originele brontekst “Keuzewijzer voor Okan leerlingen”.

	asnjë detyrim.
--	----------------

	Word Wijs , Kleine Raamhof 8, 9000 Gent wordwijs@destappgent.be of 0494 93 45 65, 0494 93 45 65 ose 0485 44 67 03
--	---

Vertaling Nederlands-Albanees.

Dit is de vertaling Albanees van "Keuzewijzer voor Okan leerlingen" en bevat identiek dezelfde informatie als de Nederlandse tekst. Deze vertaling mag enkel verspreid worden met de originele brontekst "Keuzewijzer voor Okan leerlingen".

9. Marrja e një diplome të arsimit të mesëm me anë të Komisionit të ekzaminimit për arsimin e mesëm.

Përmbajtja	<ul style="list-style-type: none">-Ju nuk ndiqni mësim por duhet të studjoni në mënyrë të pavarur.-Ju kujdeseni vetë për paisjen me librat e duhur dhe marrjen e informacionit të duhur.-Provimet bëhen në Bruksel.-Provimet organizohen gjatë gjithë vitit.-Oferta është e kufizuar dhe provimet janë kryesisht me shkrim.-Ju i planifikoni vetë provimet në bazë të datave të disponueshme.-Në gradën e tretë BSO ju duhet të vërtetoni edhe eksperiencën praktike.-Nëse doni të merrni pjesë duhet fillimisht të ndiqni një sesion informimi (online) të detyruar ku do të mësoni gjithçka rreth kësaj.
Kohëzgjatja	-varet nga trajekti juaj personal.
Fokusohet në	-marrjen e një çertifikate ose diplome të arsimit të mesëm.
Kosto-ja	<ul style="list-style-type: none">-33 euro për degë studimi-Materialet e studimit (librat...) duhet t'i blini vetë.
Kushtet e pranimit	<ul style="list-style-type: none">- Moshë juaj ose shkollimi i mëparshëm nuk ka rëndësi.-Që të regjistroheni ju nevojitet karta e identitetit (ose një dokument identiteti tjetër zyrtar).
Diploma	Ju merrni: <ul style="list-style-type: none">-çertifikatën e gradës së parë të shkollës së mesme ose-çertifikatën e gradës së dytë të shkollës së mesme (në ASO, BSO, KSO of TSO) ose-diplomën e shkollës së mesme (në ASO, BSO, KSO of TSO).
Informacion shtesë	Komisioni I ekzaminimeve: https://examencommissiesecundaironderwijs.be/ https://www.onderwijskiezer.be/v2/secundair/sec_examencommissie.php
Ndihmë	--Jeni midis 17 dhe 25 vjeç? Banoni ose studioni ose punoni në Gent? Kontakttoni Word Wijs për mbështetje në zgjedhjen, studimin dhe marrjen e një kualifikimi ose diplome të arsimit të mesëm. Është falas dhe në mënyrë vullnetare. Word Wijs, Kleine Raamhof 8, 9000 Gent wordwijs@destapgent.be ose 0494 93 45 65, 0494 93 45 65 ose 0485 44 67 03 -Leerwinkels në Flandër https://onderwijs.vlaanderen.be/nl/leerwinkels

Vertaling Nederlands-Albanees.

Dit is de vertaling Albanees van "Keuzewijzer voor Okan leerlingen" en bevat identiek dezelfde informatie als de Nederlandse tekst. Deze vertaling mag enkel verspreid worden met de originele brontekst "Keuzewijzer voor Okan leerlingen".

10. Arsimi i lartë: studimet e larta (diploma graduaat).

Përmbajtja	<p>- "Graduaat" si shkollë ndodhet midis arsimit të mesëm dhe bachelor-it profesional.</p> <p>- Ju keni nevojë për shumë praktikë (afërsisht një e treta e studimeve).</p> <p>- Ju ndiqni mësim në shkollë në kombinim me studimin e pavarur.</p> <p>- Shkolla mund të organizohet në arsim dite, nate, apo në fundjavë.</p> <p>- Ju mund ta merrni diplomën "graduaat" në një nga degët e studimit të cilat i gjeni në këtë faqe interneti: https://www.onderwijskiezer.be/v2/hoger/hoger_graduaatsopleidingen.php</p>
Kohëzgjatja	<p>- Studimet kanë nga 90 deri 120 pikë studimi.</p> <p>- Nëse ndiqni mësim gjatë ditës, kohëzgjatja është afërsisht 2 vite.</p> <p>- Nëse ndiqni mësim natën, atëherë kohëzgjatja është zakonisht 3 vite.</p>
Fokuset në	<p>- Studimet ju përgatisin për një profesion ose për të studiuar më tej në një bachelor profesional.</p>
Kosto-ja	<p>- Nëse regjistrohesh në një shkollë të lartë ju duhet të paguani kuotën e regjistrimit. Kjo shumë përbëhet nga një shumë fikse dhe një shumë variabël e cila ndryshon në varësi të pikëve të studimit të lëndëve që do të ndiqni.</p> <p>- Nëse të ardhurat tuaja janë të ulta, dhe plotësoni disa kushte të caktuara mund të keni të drejtë për një bursë studimi. Atëherë jeni student me bursë të plotë ose student me bursë të pjesshme. Më shumë informacion gjeni në https://studietoelagen.be/</p> <p>Për informacion rreth situatës tuaj personale në lidhje me bursën e studimit mund të drejtoheni tek Zyra për shërbimet ndaj studentëve të shkollës së lartë (Dienst Studentenvoorzieningen van de hogeschool): https://centenvoorstudenten.be/partners/</p>
Kushtet e pranimit	<p>- Ju keni një diplomë të arsimit të mesëm ose një çertifikatë të vitit të 6të të shkollës së mesme (keni 3 vjet që e keni marrë çertifikatën).</p> <p>- Çfarë ndodh nëse nuk keni një diplomë apo çertifikatë? Mund të kryeni një test pranimi. Testi zgjat maksimumi 100 minuta dhe përbëhet nga 4 pjesë: - fjalor, - aftësi kuptimi të asaj që lexon, - llogaritje (me makinë llogaritëse), - llogjikë numerike (me makinë llogaritëse). Për të kaluar duhet të merrni në total të paktën 50 %.</p>
Diploma	<p>Ju do të merrni:</p> <p>- një diplomë "graduaat" ('Associate degree').</p> <p>- Ju mund të merrni në të njëjtën kohë edhe një diplomë të arsimit të mesëm nëse është e nevojshme. Për këtë ju ndiqni (Formim-in e përgjithshëm shtesë - AAV) tek një CVO, shikoni informacionin rreth arsimit të mesëm për të rritur në faqen 9.</p>
Informacion shtesë	<p>Informacion rreth studimeve të tipit "graduaat" në Flandër i gjeni tek Onderwijskiezer https://www.onderwijskiezer.be/v2/hoger/hoger_graduaatsopleidingen.php</p> <p>Përmbledhjen e studimeve "graduaat" në Oost-Vlaanderen i gjeni në faqen e internetit të 3 shkollave të larta:</p> <ul style="list-style-type: none">• Arteveldehogeschool• Hogeschool Gent

Vertaling Nederlands-Albanees.

Dit is de vertaling Albanees van “Keuzewijzer voor Okan leerlingen” en bevat identiek dezelfde informatie als de Nederlandse tekst. Deze vertaling mag enkel verspreid worden met de originele brontekst “Keuzewijzer voor Okan leerlingen”.

	<ul style="list-style-type: none">• <u>Odisee</u>
Ndihmë	<p>- De Stap- Leerwinkel Oost-Vlaanderen, info@destagent.be , 09 233 75 15, tek biblioteka De Krook, kati i dytë, Miriam Makebaplein 1, 9000 GENT. www.destagent.be</p> <p>-IN-Gent vzw (ojf), Kongostraat 42, 9000 Gent, 092657840 / faqja e internetit https://www.in-gent.be/voor-jou/onderwijs/zoek-je-eeen-school/voor-jezelf</p>

Vertaling Nederlands-Albanees.

Dit is de vertaling Albanees van "Keuzewijzer voor Okan leerlingen" en bevat identiek dezelfde informatie als de Nederlandse tekst. Deze vertaling mag enkel verspreid worden met de originele brontekst "Keuzewijzer voor Okan leerlingen".

11. Arsimi i lartë: HBO5 infermieri.

Përmbajtja	<p>- Ju do keni shumë praktikë.</p> <p>- Ju mësoni teorinë që keni nevojë për ta bërë mirë punën.</p> <p>- Këto studime "graduaat" ndodhen midis shkollës së mesme (SO) dhe bachelor-it profesional.</p> <p>- Ju ndiqni (zakonisht) mësim gjatë ditës. Mund ta ndryshoni trajektin nëse punoni.</p> <p>- Është një "graduaat", por ju e ndiqni këtë në një shkollë për arsimin e mesëm me kohë të plotë. Për këtë shkollë bashkëpunon me një shkollë të lartë.</p> <p>- Cila është diferenca me një bachelor profesional (PBA) për Infermieri (shikoni më shumë informacion në faqen 15)?</p> <ul style="list-style-type: none"> ✓ HBO5 Infermieri: trajekti model zgjat 3 vite. Ju e ndiqni në një shkollë për arsimin e mesëm. ✓ Bachelor-i profesional për Infermieri ka një kohëzgjatje të studimit prej 240 pikësh studimi, në një trajekt model kjo është 4 vite. Ju e ndiqni këtë në një shkollë të lartë. ✓ Ju nuk paguani kuotë për regjistrimin për HBO5 infermieri. ✓ Studimet HBO5 për infermieri janë të orientuara ndaj praktikës dhe i përshtaten studentëve.
Kohëzgjatja	<p>- 3 vite dhe përbëhet nga 5 modula.</p> <p>- Ju mund të filloni në 1 shtator dhe në 1 shkurt.</p>
Fokusohet në	<p>- profesionin e infermieres/it (pas modulave bazë juve merrni dhe statusin e zorgkundige (ndihmës(e) për ushqimin/veshjen/larjen etj).</p> <p>- Në varësi të shërbimit ku ju punoni ju mund të bëni të njëjtën punë si një koleg që ka mbaruar studimet bachelor. Por disa specializime ose funksione drejtuese mund të përfitohen vetëm nga ata që kanë diplomë bachelor.</p> <p>- Ju mundet edhe të ndiqni një trajekt plotësues në një shkollë të lartë për të marrë diplomën bachelor.</p>
Kosto-ja	<p>- Nuk ka kosto për regjistrimin.</p> <p>- Duhet të paguani para për kursin si psh. koston e vizitave në kuadrin e studimeve, blerja apo marrja me qera e uniformës së spitalit, etj.</p>
Kushtet e pranimit	<p>- një diplomë të arsimit të mesëm</p> <p>- ose një çertifikatë të gradës së 3të të BSO (mund të jeni edhe nën 18 vjeç)</p> <p>- ose një çertifikatë të arsimit të mesëm për të rriturit (minimumi 900 orë mësimi)</p> <p>-Nuk e keni mbaruar shkollën e mesme? Nëse jeni më i madh se 18 vjeç, mund të filloni me studimet nëse bëni një test pranimi i cili organizohet nga shkollat e mesme. Shkolla ju teston diturinë e Holandishtes dhe bërjen e llogaritjeve. Mbase ju duhet të shkruani dhe një letër motivacioni.</p>
Diploma	<p>- Ju do të merrni një diplomë "graduaat" në infermieri.</p> <p>- A keni një atest të gradës së 2të të shkollës së mesme (4SO)? Atëherë merrni automatikisht diplomën e shkollës së mesme pasi të kaloni me sukses studimet HBO5 në infermieri.</p> <p>-Keni një çertifikatë 6 BSO të cilën e keni marrë maksimumi 4 vite më parë, në kombinim me çertifikatën AAV të marrë në një CVO (shikoni për informacion rreth AAV faqen 11). Atëherë ju merrni diplomën e shkollës së mesme pas dy modulave bazë (pas 1 viti HBO5). https://www.onderwijskiezer.be/v2/volwassen/volw_gndiploma_plus18.php?age=2&var=verpleegkunde</p> <p>-Shikoni vërtetimet e shkollës së ndjekur në vendin tuaj. Mbase mund t'i përdorni. Keni ndjekur mësim në shkollën e mesme në Flandër? Mbajni mirë rezultatet. Një çertifikatë të gradës së dytë SO (4SO) mund ta merrni edhe me anë të komisionit të ekzaminimit (shikoni për informacion faqen 12).</p>
Informacion shtesë	<p>Ju mund të përgatiteni për këto studime me anë të HALLKËS SOCIALE (SOCIALE SCHAKEL plusKLAS) (OKAN pas OKAN). Kërkoni më shumë informacion tek personi udhëzues i juaj tek OKAN.</p> <p>Ju mund të përgatiteni duke ndjekur një parastudim rreth social profit për ata që nuk e kanë Holandishten gjuhën amtare, tek VDAB-ja (shikoni për informacion rreth VDAB-së faqen 7). Faqja e internetit: https://www.vdab.be/opleidingen/aanbod/904306/Vooropleiding_social_profit_voor_anderstaligen</p> <p>Infermiera është një profesion shumë i kërkuar. Me anë të VDAB-së ju mund të merrni diplomën për infermieri HBO5 https://www.vdab.be/zorg . VDAB ju paguan normalisht materialet e mësimi. Nganjëherë merrni dhe rimbursime si psh. për vajtje-ardhjen në mësim. Ju duhet të regjistroheni si punë-kërkues.</p> <p>Informacion rreth HBO5 infermieri: https://www.onderwijskiezer.be/v2/hoger/hoger_hbo_detail.php?richting=70</p>
Ndihmë	<p>- De Stap- Leerwinkel Oost-Vlaanderen, info@destapgent.be , 09 233 75 15, tek biblioteka De Krook, kati i 2të, Miriam Makebaplein 1, 9000 GENT. www.destapgent.be</p> <p>-IN-Gent vzw (ojf), Kongostraat 42, 9000 Gent, 092657840/website https://www.in-gent.be/voor-jou/onderwijs/zoek-je-eeen-school/voor-jezelf</p>

Vertaling Nederlands-Albanees.

Dit is de vertaling Albanees van "Keuzewijzer voor Okan leerlingen" en bevat identiek dezelfde informatie als de Nederlandse tekst. Deze vertaling mag enkel verspreid worden met de originele brontekst "Keuzewijzer voor Okan leerlingen".

--	--

Vertaling Nederlands-Albanees.

Dit is de vertaling Albanees van "Keuzewijzer voor Okan leerlingen" en bevat identiek dezelfde informatie als de Nederlandse tekst. Deze vertaling mag enkel verspreid worden met de originele brontekst "Keuzewijzer voor Okan leerlingen".

12. Arsimi i lartë: Bachelor

Përmbajtja	<p>- Ju mund të zgjidhni midis një bachelor-i profesional (PBa) ose një bachelori akademik (ABa).</p> <p>-Bachelor-in profesional (PBa) e ndiqni në një shkollë të lartë. Kjo përmban: një formim të përgjithshëm, njohuri profesionale specifike, praktikë/mësim në vendin e punës.</p> <p>Bachelor-in akademik (ABa) dhe pastaj një master (Ma) e ndiqni në një universitet/ shkollë Artesh. Ato e vënë theksin tek formimi i gjerë (teorik) akademik, i bazuar në studime shkencore ose një formim në fushën e arteve.</p>
Kohëzgjatja	<p>-180 pikë studimi, trajekti model: 3 vite studimi me kohë të plotë -përfundim për infermierinë: 240 pikë = trajekti model 4 vite studimi me kohë të plotë</p>
Fokuset në	<p>-PBa fokusohet në ushtrimin direkt të profesionit. Ju mund të dilni direkt në tregun e punës ose me anë të një programi hallkë të kaloni në studimet master.</p> <p>-ABa fokusohet në: -përgatitje për Master-in, -studime shkencore/formim në fushën e arteve,</p>
Kosto-ja	<p>-Për regjistrimin në një shkollë të lartë ose universitet ju paguani kuotën për regjistrimin.</p> <p>-Nëse të ardhurat tuaja janë të ulta, ju mund të keni të drejtë për një bursë studimi, nëse plotësoni disa kushte. Në këtë rast do jeni student me bursë të plotë ose të pjesshme.</p> <p>Më shumë informacion gjeni në https://studietoelagen.be/ Për informacion rreth situatës tuaj personale ju mund të drejtoheni tek zyra për shërbimet ndaj studentëve (STUVO) të universitetit ose shkollës së lartë: https://centenvoorstudenten.be/partners/</p>
Kushtet e pranimit	<p>-Ju mund të filloni nëse keni një diplomë të shkollës së mesme (shikoni informacionin në faqen 11-12). Nuk e keni këtë, atëherë mund të merrni pjesë në një test pranimi (nga mosha 21 vjeçe).</p> <p>-Keni një diplomë të shkollës së mesme të vendit tuaj? A jua jep kjo diplomë të drejtën të filloni studimet e larta në universitet në vendin tuaj? Atëherë mund t'a përdorni atë dhe në Flandër me anë të një procedure pranimi. Juve ju duhet një kopje e legalizuar e diplomës ose një Apostille. Më shumë informacion gjeni këtu: https://www.ugent.be/nl/opleidingen/bacheloropleidingen/toelating/diploma.htm</p> <p>-Ju mund edhe të filloni në arsimin e lartë me një diplomë "gradaat" (shikoni informacionin në faqen 13, 14)</p> <p>-Për studimet në mjekësi dhe dentari duhet të bëni një provim pranimi të detyruar.</p> <p>-Për studimet në shkollën e arteve ka provime artistike pranimi të detyruara.</p> <p>-Ka teste pranimi të detyrueshme, si dhe prova që tregojnë nivelin tuaj për ata që duan të fillojnë studimet për inxhinjeri shkencore, veterinar, arkitekturë, shkollat edukative... Kjo është për të parë nëse keni njohuri të mjaftueshme nga shkolla e mesme dhe nëse e arrini nivelin e duhur për pranimin. Këto teste janë të detyruara, por jo vendimtare. Nëse nuk i kaloni mund të filloni studimet, por ta dini që do hasni vështirësi.</p> <p>-Pothuajse të gjitha shkollat e arsimit të lartë janë në gjuhën Holandeze. Nëse nuk keni ndjekur një vit të plotë në shkollën e mesme, atëherë ju duhet që të keni minimumin një çertifikatë të Holandishtes së nivelit B2 ose të kaloni provimin e pranimit për dentist/mjek.</p> <p>-Edhe nëse doni të studioni në Anglisht, duhet ta vërtetoni njohurinë rreth kësaj gjuhe. Ju duhet të keni minimumi një atest B2 ose të keni ndjekur me sukses 1 vit të një shkolle në Anglisht. Kontrollojeni dhe njëherë vetë nivelin e kërkuar të Anglishtes tek vetë institucioni arsimor.</p>
Diploma	<p>-një diplomë të një bachelor-i profesional (të fokusuar në tregun e punës) -ose një diplomë të një bachelor-i akademik (të fokusuar në studimet master)</p>
Informacion shtesë	<p>Struktura e arsimit të lartë https://www.onderwijskiezer.be/v2/hoger/hoger_structuur.php</p> <p>Ju mund të përgatiteni për arsimin e lartë duke ndjekur një vit parapërgatitor në shkollën e mesme. https://www.onderwijskiezer.be/v2/secundair/sec_3graad_vi.php</p> <p>Një mundësi tjetër për t'u përgatitur për arsimin e lartë është Paratrajekti për arsimin e lartë për të rinjtë me gjuhë tjetër amtare (Voortraject Hoger onderwijs voor anderstaligen). https://in-gent.be/voor-iou/onderwijs/voortraject-hoger-onderwijs</p>

Vertaling Nederlands-Albanees.

Dit is de vertaling Albanees van "Keuzewijzer voor Okan leerlingen" en bevat identiek dezelfde informatie als de Nederlandse tekst. Deze vertaling mag enkel verspreid worden met de originele brontekst "Keuzewijzer voor Okan leerlingen".

Ndhmë	<p>-Zyra e shërbimeve për studentët e shkollës së lartë: Shkollat e larta & universitetet https://centenvoorstudenten.be/partners/</p> <p>-De Stap- Leerwinkel Oost-Vlaanderen, info@destappgent.be , 09 233 75 15, tek biblioteka De Krook, kati i 2të, Miriam Makebaplein 1, 9000 GENT. www.destappgent.be</p> <p>-IN-Gent vzw , Kongostraat 42, 9000 Gent, 092657840/faqja e internetit https://www.in-gent.be/voor-jou/onderwijs/zoek-je-een-school/voor-jezelf</p>
-------	---

Vertaling Nederlands-Albanees.

Dit is de vertaling Albanees van “Keuzewijzer voor Okan leerlingen” en bevat identiek dezelfde informatie als de Nederlandse tekst. Deze vertaling mag enkel verspreid worden met de originele brontekst “Keuzewijzer voor Okan leerlingen”.

PËRMBLEDHJE



Tregues përzgjedhës për nxënësit 18 vjeçarë të OKAN

IN-Gent (ojf) në bashkëpunim me De Stap - Leerwinkel Oost-Vlaanderen

IN-Gent v.z.w. (ojf)

Kongostraat 42
9000 Gent

Nr. i telefonit 09 265 78 40

E-mail-i info@in-gent.be

Faqja e internetit www.in-gent.be

Pyetje/sugjerime

Ludmila Vysotskaya

Bashkëpunëtore për udhëzimin e minorenëve në sistemin e arsimit

Departamenti “Udhëzimi individual”

ludmila.vysotskaya@in-gent.be

Layout

IN-Gent vzw (ojf)

Publikuar më

Maj 2021

Botuese përgjegjëse

Astrid De Bruycker, përfaqësuese e IN-Gent vzw (ojf), Kongostraat 42, 9000 Gent